

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Klllokotit z. Saša Mirkovič**

I nderuari z. Mirkovič,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Rregullimin e infrastrukturës në qytet dhe te fshatra;
- Ndërtimin e sistemit të kanalizim dhe rrjetit të ujësjellësit;
- Largimin e mbeturinave;
- Asfaltimin e rrugëve lokale;
- Mirëmbajtjen e ambientit ;
- Banimin e sigurt dhe të drejtë për të gjithë qytetarët, duke përfshirë serbët, shqiptarët dhe romët;
- Zvogëlimin e problemit të furnizimit me energji elektrike dhe ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për pagesën e saj;
- Uljen e papunësisë (punësimin e një anëtari nga çdo familje, qoftë në komunë apo ndërmarrje tjera);

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN)